



Ndërmarrja Publike Qendrore
Posta e Kosovës Sh.A

PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.O.
Nr./No./Br. 01-656/26
Data/Date/Datum 08-04-2026
PRISHTINE-PRISTINA-PRISTINA

Nr. 27/26

Datë: 07/04/2026

Në bazë të kompetencave të Bordit të Drejtorëve sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe në përputhje me nenin 4, 5 dhe nenin 94 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pas shqyrtimit të procesit të rekrutimit për pozitën e punës Këshilltar/i /e Përgjithshëm/Sekretar/i/e Korporatës të konkursit nr.01-42/26 të datës 13.01.2026, Bordi i Drejtorëve i NPQ “Posta e Kosovës” Sh.A. në mbledhjen nr. 06/2026 të mbajtur më datë 07.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

1. ANULOHET Konkursi Publik nr.01-42/26 datë 13.01.2026, për pozitën e punës Këshilltar/i /e Përgjithshëm/Sekretar/i/e Korporatës ne Posten e Kosoves sh.a.
2. Obligohet Resurset Njerëzore që të ndërmarrë veprimet për rishpalljen e konkursit Publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Konkursi publik sipas pikës 2 të këtij vendimi rishpallet dhe mbetet i hapur për 15 ditë.
4. Kriteret, detyrat dhe përgjegjësit dhe koeficienti përcaktohen në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative, Statutin e Ndërmarrjes, Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe akteve tjera të ndërmarrjes.
5. Konkursi publik të rishpallet në të gjitha portalet e ndërmarrjes si dhe në disa platforma online më të popullarizuara për punësim.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

A r s y e t i m

Bordi i Drejtorëve të NPQ “Posta Kosovës” Sh.A, ka mbajtur takimin e rregullt nr.06/2026 më datë 07.04.2026, si pikë nr.3 të takimit, kishte “ *Shqyrtim i procesit të konkursit, për pozitën e punës Këshilltar/i /e Përgjithshëm/Sekretar/i/e Korporatës sipas konkursit*”.

Gjatë procesit të verifikimit paraprak të aplikacioneve, është konstatuar një lëshim procedural, me ç’rast në listën e kandidatëve të kualifikuar për fazat e mëtejme është përfshirë një kandidat që nuk ka përmbushur një nga kriteret e detyrueshme të konkursit, konkretisht dëshminë mbi përvojën e punës të verifikuar përmes Trustit Pensional.

Mosplotësimi i këtij kriteri në momentin e verifikimit paraprak e bën kandidatin të pakualifikueshëm për fazat e mëtejme të procedurës, përfshirë edhe fazën e intervistës. Përkundër kësaj, kandidati është përfshirë në proces, duke përbërë devijim nga kushtet e konkursit.

Ky veprim është në kundërshtim me:

- nenin 4 (Parimi i ligjshmërisë) dhe nenin 5 (Parimi i trajtimit të barabartë) të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;

dhe nuk siguron barazinë e kandidatëve, transparencën dhe integritetin e procesit të rekrutimit. Duke qenë se ky lëshim ka ndodhur në një fazë themelore të procedurës (verifikimi i kriterëve) dhe ka ndikuar në përbërjen e listës së kandidatëve për intervistë, procesi në tërësi konsiderohet juridikisht jo i rregullt, dhe nuk mund të korrigjohet në mënyrë selektive pa cenuar parimet themelore të procedurës, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesues i Bordit të Drejtorëve



Gezim Paci

I dërgohet:

- 1x Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve;
- 1x Kryeshefit Ekzekutiv të PK-së;
- 1x KP/SK të PK-së;
- 1x U.D ZKFTH-së;
- 1x Aksionarit – NJPMNP;
- 1x Resurseve Njerëzore;
- 1x Arkivës të PK-së.